



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione  
Mbledhja nr. 07

Prishtinë, më 25. 05. 2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
Persona të Pagjetur dhe Peticione.

**Në mbledhje morën pjesë:** Suzana Novoberdaliu – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj - nënkryetare, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari Duda Balje, Justina Shiroka-Pula dhe Albana Gashi.

**Mungoi:** Ismet Beqiri.

E ftuar: Edita Tahiri-zëvendëskryeministre e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Elita Vokshi dhe Lejla Selimi – OSBE, Jahir Bejta-Ngritja e Zërit, Nexhat dhe Nafie Kuqi nga Sindikata e Pavarur e Invalidëve dhe Pensionistëve të Kosovës dhe Burim Tahiri, praktikant nga Kuvendi i Kosovës.

**Nga Stafi Mbështetës i Komisionit:** Rrahim Demaj – koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi: Suzan Novoberdaliu – kryetare.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Takim me zëvendëskryeministren, z. Edita Tahirin, përkitazi me bisedimet me Serbinë, lidhur me personat e pagjetur dhe fondin e pensioneve,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 04.05.2011,
4. Caktimi i datës së vizitës në burgun e Dubraves.
5. Njoftim lidhur me rregullat e procedurës për zgjidhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij.
6. Caktimin e raportuesit lidhur me monitorimin e Ligjit për liritë fetare nr 2006/2-2-L31
7. Njoftim i grupit punues deri ku ka arritur puna në monitorimin e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje,
8. Të ndryshme.

**Kryetarja** konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi I rendit të ditës

Rendi I ditës u miratua pa ndryshime

2. Takim me zëvendëskryeministren, z. Edita Tahirin, përkitazi me bisedimet me Serbinë, lidhur me personat e pagjetur dhe fondin e pensioneve,

**Kryetarja** kerkoi nga ajo që të na njoftoj për zhvillimet e bisedimeve që i ka pasur me palen serbe, për të pagjeturit dhe fondin penasional, dhe pastaj anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të bëjnë pyetje.

**Edita Tahiri-** Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës shpreh kënaqësinë që janë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjindore Personave të Pagjetur dhe Peticione.

Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të Kushtetutës është hartuese dhe zbatuese e politikave të jashtme, dhe dialogu teknik është një aktivitet ndërkombtar, që i takon Qeverisë të realizojë në kuadër të kompetencave kushtetuese. Fakti se ky dialog u mbështet nga aleatët dhe miqtë tanë ndërkombtar përendimor ishte një argument shumë për këto qeshtje dhe si arsye e fundit ishte miratimi i Rezolutes nga Kuvendi i Kosovës me të cilën e mbështeti dialogun por i dha qartë edhe vijat e kuqe.

Për qeshtjen e të pagjeturve mund t'ju them se në kemi vlersuar në bazë të informacioneve që kemi marrë nga Komisioni shtetror për të pagjeturit i cili tani është në dialog gati 7 vjeçar me Serbinë për qeshtjen e të pagjeturve, pashtaj kemi pasur takim me shoqatat e të pagjeturve, poashtu kemi biseduar me departamentin për mjeksine ligjore pastaj, me UNMIK-un, me EULEX-in, në mënyrë që të marrim njohurit e duhura dhe të gjykojmë se me çfarë qasje të bëhet dialogu teknik që ti qaset qeshtjes së të pagjeturve. Nga njoftimet që kemi marrë është parë se në periudhën 7 vjeçare ka pasur progres në identifikimin e të pagjeturve, fillimisht numri ka qenë rreth 6000 ndërsa sot dikun rreth 1800 njerz mbeten me fat të pazbardhuar. Në kemi menduar që ky dialog teknik duhet ta fuqizojë këtë proces. Në kemi kerkuar nga qeveria e Serbisë për një angazhim për zbardhjen, kemi kerkuar rritjen e kembimit të informacionit për rastet që duhet të identifikohen veqmas kemi theksuar informacionet që disponon ushtria serbe, sepse ajo ka qenë direkt e involvuar në këto krime. Poashtu kemi kerkuar identifikimin e varrezave të tjera masive që mund të kenë si dhe kemi njoftuar se Kosova po i plotson të gjitha kërkesat që kanë dale nga dialogu si dhe nga raporti i progresit 2010.

Kemi diskutuar qeshtjen e rritjes së kapaciteteve që ekipet profesionale të shtojnë të gjitha komponentat e duhura për trajtimin e këtij problemi.

. Dua të ju njoftoj se në tre fusha kemi përparime esenciale është fjala për levizjen e lire ku jemi shumë afër marrëveshjeve dhe me këtë rast unë mund të theksoj se nga kjo marrëveshje qytetarët e të dyja vendeve do të mund të levizin lirshëm. Për sa i takon tregtisë së lira ka një kohë të gjatë që jemi në një situatë asimetrike sepse Serbia eksporton në Kosovë ndërsa në nuk mund të eksportojmë në Serbi mandej nuk kemi

mundur te perdorim territorin e serbise as si tranzit per te kaluar ne vendet e tjera. Ne baze te deklarimeve te pales serbe ka sinjale positive se kjo qeshtje mund te zgjidhet shpejte, ndersa BE –ja mbeshtet plotesisht qe vulat e doganave te Kosoves te njihen sepse Be- ja I ka njohur prandaj edhe Serbia si aspirante per BE duhet ti njohe. Edhe ne qeshtjet e energjise jemi shum afer marreveshjes, propozimi I yne ka qene ne kuader te parimeve te athines per energjine e cila nenkupton qe operatoret energjetik ne Kosove dhe ne Serbi duhet te njihen reciprokisht dhe duhet te vendsoin bashkepunimin. Ne fund dua te them se objektivat tona jane qe te mundesojne nje cilesi me te mire per jeten e qytetareve, qe te kemi mundesi si Qeveri e Kosoves te japim sherbime te mira te gjithë qytetareve madje edhe pjesese veriore qe kane ende dilemma ne raport me integrimin dhe realitetin ne institucionet e Kosoves, pastaj po kontribuojme ne bashkepunimet rajonale si dhe po deshmojme para BE-se se ne jemi nje shtet serioz, I marim obligimet i plotesojme standardet por duke I kryer keto obligime qe jane te dyfishta po rrisim standardin jetesor permes reformave dhe po I afrohem Evropes, ne kete rast kerkojme edhe nga BE-ja qe te vleresojte te gjitha keto dhe sa ma shpejte te mare edhe liberalizimin e vizave, te hyje ne marredhenie kontraktuale me Bashkimin Evropian dhe te pershpejtohet statusi I kandidatit per Kosoven sepse vonesat qe jane bere per Kosoven nuk jane me fajin e Kosoves. Une ju falenderoj dhe tani jame e gatshme per pyetjet e juaja.

**Justina Pula – Shiroka** – e falënderoi per njoftimet e ofruara dhe tha se qellimi jone eshte te jemi pjese e Evropes dhe nese ky dialog dhe te gjitha objektivat qe I keni parashtruar ju ne kuader te dialogut do te kene sukses, duhet te jemi te kenaqur qe jemi ne rruge te drejte dhe jemi duke punuar drejte. Ajo poashtu tha se ne qofte si individe qofte I antare te Komisionit do tju perkrahim ne keto qeshtje dhe sa here te keni kesi bisedime une kerkoj qe ju te diskutoni me te gjithë perfaqesuesit ketu sepse mund te japin ndonje informate qe mund tju ndihmoj.

**Rita Hajzeraj – Beqaj** – Pershendeti te pranishmit dhe e falenderoi znj kryeministre per informacionet e dhena. Ajo e pyeti se a eshte caktuar ndonje afat kohor, pasi qe eshte caktuar nje platoforme dhe bisedimet do te zhvillohen ne etapa ateher sa do te zgjasin keto etapa, pra deri kur ne do te mund te bisedojme. Pyetja tjeter eshte sa I perket strukturave paralele sepse ne e dime qe qeshtje e Mitrovices ende nuk eshte preke dhe po pretendohet qe te preket nga pala serbe. Aeshte bisedu ndonjeher per qeshtjen e egzistimit te strukturave paralele, bandabve kriminale dhe perfaqesuesit e MUP-it Serb qe ndodhen ne territorin e Kosoves. Sa i perket te pagjeturve si ka qene qendrimi i pales Serbe ne bisedime sa kane qene te gatshem per dhenien e informative pasi qe e dine se ku ndodhen varrezat masive, pra si ka qene pergjigja e tyre. A e konsideroni qe ne fund pas ketyre bisedimeve qe jane te inicuar nga Bashkimi Evropian, a e kane parapare qe do yte jente njohja e Pavarësisë së Kosoves nga pala Serbe apo vetem zbutja e raporteve.

**Kymete Bajraktari** – I parashtrroi disa pyetje. Ajo pyeti se a e kane regjistrin e plote te personave te pagjetur apo jane duke e shfrytezuar ende regjistrin e te pagjeturve nga Kryqi i Kuq. Pyetje tjeter ishte se kush eshte ne perberje te delegacionit ekskluzivisht për te zhdukurit. Ajo poashtu pyeti se qka eshte duke u bere ne qeshtjen e ndjekjes se krimineleve dhe se vendi I tyre I gjykimit duhet te jete ne vendin e krimit e jo ne Beograd.

**Albana Gashi** - pyeti se a e kane ndermend te bisedohet per shkaktaret e zhdukjes se 1800 personave qe jane ne listen e permendur nga znj Edita Tahiri. Ajo poashtu pyeti se a eshte cekur afati kur, dhe kush eshte pergjegjes ne Beograd per qeshtjen e te pagjeturve. Ajo pyeti edhe per ekspertin nga Kosova qe merret me qeshtjen e te pagjeturve ne keto bisedime.

**Biserka Koqstic**-shprehi interesimin e saj per fatin e te pagjeturve nga komuniteti jo shqiptare, per fondin e pensioneve si dhe ngriti shqetesimin e procesit te privatizimit nga ana e Agjensionit per privatizimin e tokave

**Kurtan Kajtazi**, e pergezoi per gadishmerin per te marre pjese ne mbledhjen e komisionit, dhe tha “E kuptoj rolin e zevendes kryeministres ne keto bisedime e dime qe nuk eshte nje gje e leht prandaj vetem e pershendes,”

**Edita Tahiri**, iu pergjigj pyetjeve te shtruara nga te pranishmit si dhe pytjes e parafolëses dhe tha se sa i perket qeshtjes se zbardhjes se fatit te te pagjeturve Qeveria e Republikes se Kosoves angazhohet per zbardhjen e te gjithë te pagjeturve pa dallime etnike, ky eshte angazhim i yni politik kushtetues dhe qytetare.

Ndersa çështja e privatizimit eshte qeshtje e sovranitetit te Kosoves dhe qytetaret duhe me na u drejtuar neve per mes agjensionit per privatizim, ndersa sa i perket fondit une veq fola dhe u pergjegja me heret.

### **3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 04.05.2011,**

*Kryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 04.05.2011 .*

### **4.Caktimi i datës se vizitës ne burgun e Dubraves.**

Komisioni u pajtuan qe vizitën ne kete institucion ndëshkimor ta bëjnë ditën e hënë me 6 qershor dhe nisja te behet ne orën 10.00 nga Kuvendi i Kosoves.

### **5. Njoftim lidhur me rregullat e procedurës për zgjidhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij.**

**Kryetarja**, ne seancën e kaluar është miratuar rregullorja për zgjedhjen e avokatit te popullit dhe 5 zëvendësve te tij, ne e dimë se avokati është i zgjedhur dhe se tani duhet te zgjedhen zëvendësit e tij, ndërsa ne panelin intervistues do te jet i tere komisioni përjashtimisht qe dy partitë PDK dhe LDK duhet te ken ne panel vetem nje antare

### **6. Caktimin e raportuesit lidhur me monitorimin e Ligjit për liritë fetare nr 2006/2-2-L31**

**Kryetarja**, tha ne procedure te monitorimit e kemi ligjin për mbrojtjen nga dhuna ne familje, sa i perket ligjit për lirit fetare ne do caktojmë një grup punues i Komisioni lidhur me këtë pikë nxori këtë :

## P ë r f u n d i m

Komisioni vendosi qe si raportuese për monitorimin e ligjit për liritë fetare te caktohet Kymete Bajraktari.

### **7. Njoftim i grupit punues deri ku ka arritur puna në monitorimin e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna ne familje,**

**Kryetarja,** e ftoi Albana Gashi të informoj lidhur me monitorimin e ligjit për mbrojtjen nga dhuna ne familje

**Albana Gashi,** ne fillim kam një ankesë për dy anëtarët e grupit punues qe nuk marrin pjese ne mbledhjet e grupit punues, çdo takim unë jam vet me stafin e administratës, Ajo tha se pasur probleme me zyrtarët e ministrive te cilët është e vështir për ti kontaktuar dhe për te ardhur ne takime,ne mbledhjen qe do ta kem sot kemi te ftuar ministrin e drejtësisë dhe te shendetesise dhe tani jam e njoftuar se paskan ardhur zyrtarët e këtyre dy ministrive, kemi pasur takim me agjencionin për barazi gjinore, ministrin për pune dhe mirëqenie sociale, drejtoreshën e qendrës për mbrojtjen e fëmijëve dhe grave dhe policinë e kosoves, thuajse te gjitha kane problem mungesën e buxhetit, ne kemi planifikuar edhe disa takime ne gjykata dhe prokurori dhe sa i përket caktimit te tryezës kemi ende do pune dhe do te kemi me shume informacione dhe tani do caktojmë datën për tryezë.

### **8. Të ndryshme.**

**Kryetarja,** tha ne qeveri ka kaluar projektligji për personat e zhdukur, kemi informacione se është proceduar ne kuvend, pasi qe te kaloj ne leximin e pare ne kuvend ne do ta kem për shqyrtim si komision funksional dhe ne mbledhjen e radhës do te caktojmë një raportues për këtë projektligj.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit  
Suzan Novoberdaliu